



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
PRIVREDNI SUD KOSOVA – COMMERCIAL COURT OF KOSOVO

---

AD/GjKK.nr.3/23

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** – Autoriteti Kompetent - Kryetari Gjykatës Mahir Tutuli, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar më 15.08.2023 nga E.Ç. – përfaqësues ligjor i Komunës Skenderaj, për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares V.P.R., me pretendimin për shkelje disiplinore, bazuar në dispozitën e nenit 9, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 04.09.2023 merr këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore e ushtruar nga E.Ç., ndaj gjyqtares V.P.R., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, përkatësisht autoriteti kompetent i kësaj gjykate, më 15.08.2023, përmes postës elektronike ka pranuar nga përfaqësuesi ligjor i Komunës së Skenderajt – E.Ç., ankesë për iniciimin e procedurës disiplinore kundër gjyqtares së Dhomave të Shkallës së Parë - V.P.R., me pretendimin për shkelje disiplinore, shkelje të etikës profesionale, njëanshmëri gjatë procedurës gjyqësore dhe arsyeve të tjera subjektive.

Parashtruesi i ankesës në cilësi të përfaqësuesit ligjor të të paditurës, në ankesën për inicim të procedurës disiplinore pretendon se gjyqtarja V.P.R., në seancën përgatitore të datë 14.08.2023, në çështjen juridike administrative të evidentuar si: KA.nr.226/22, nuk ka vepruar drejtë dhe ka shkelur parimin e etikës profesionale, paanësisë dhe paanshmërisë, duke mohuar të drejtën ligjore

të përfaqësuesit të kërkuar gjatë seancës, për përjashtimin e të njëjtës nga ky proces gjyqësor, kërkesë kjo e cila sipas tij qëllimshëm dhe me tendence nuk është konstatuar në procesverbal, por është udhëzuar që të njëjtën ta dorëzoj përmes parashtresës me shkrim pas përfundimit të seancës, e gjithë kjo me qëllim të mbrojtjes së paditësit dhe jo ndarjes së drejtësisë.

Në ankesën e parashtruar, po ashtu është theksuar se gjyqtari i çështjes ka marr aktvendim pa propozimin e përfaqësuesit të paditësit për kundërshtim, dhe aktvendim për lejimin e ndryshimit të padisë në kuptimin subjektiv: *“Gjyqtarja disa here ka kërkuar nga avokati i paditësit ta bëj zgjerimin e padisë në kuptimin subjektiv në drejtim të MMPH-së, por i njëjti zgjeroi padinë në drejtim të Drejtorisë së Inspektoratit, edhe pse këtë pjesë qëllimisht gjyqtarja nuk e ka specifikuar në procesverbal. Gjyqtaria duke e parë këtë gjë se nuk po e bënë ashtu siç po dëshiron e cila kishte qëllim ta luante rolin e avokates dhe ta mbronte paditësin të njëjtit ja ndërprente fjalën dhe pa propozimin e tij merr aktvendim si në faqen 3 dhe 4 të cilat pika të aktvendimit në pjesë të caktuara ka ndërhyrje flagrante nga gjyqtaria në fund e bindi avokatin e palës paditëse ta zgjeroj padinë në drejtim të MMPH-së... kemi kërkuar nga gjyqtaria që ta ndërpres procesin dhe kam kërkuar që ajo të tërhiqet nga ky proces gjyqësorë në trajtimin e kësaj lënde për arsye të një anshmërisë dhe subjektivitetit të skajshëm në mbrojtjen e paditësit”,* thuhet ndër të tjerash në ankesë.

Kryetari i Gjykatës pas pranimit të ankesës, më datë 16.08.2023 bazuar me nenin 9 paragrafi 5 të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Nr. 05/L-057, ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, lidhur me ankesën me shkrim për Përgjegjësi Disiplinore për gjyqtaren V.P.R..

Bazuar në nenin 6 paragrafi 4 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, kryetari i gjykatës më 16.08.2023, ka kërkuar nga gjyqtarja V.P.R. deklaratë me shkrim lidhur me kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore.

Më 18.08.2023, gjyqtarja V.P.R. në deklaratën e saj të dhënë me shkrim, lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesën për inicimin e procedurës disiplinore, ka thënë se seanca e datë 14.08.2023 ka qenë e vështirë për tu menaxhuar për shkak të sjelljes jo profesionale të përfaqësuesve të të dyja

palëve dhe sjelljes pa respekt ndaj gjykatës. Sipas saj nuk qëndrojnë pretendimet e paraqitësit të ankesës, se e njëjta ka qenë e njëanshme, subjektive apo të ketë treguar sjellje joprofesionale.

Sipas saj përfaqësuesit të paditësit i është dhënë fjala të deklarohej, ndërsa pretendimet e tij se me marrjen e aktvendimit janë bërë shkelje të dispozitave ligjore janë konstatuar në procesverbal, e njëjta ka shtuar se palëve disa herë u është tërheq vërejtja dhe janë paralajmëruar për pasojat nëse vazhdojnë me sjellje të njëjta, dhe kjo është konstatuar edhe në procesverbal. *“I njëjti i frustruar deklaroj se nuk do ta nënshkruaj procesverbalin, dhe krejt pas përfundimit të seancës tentoj të bëjë kërkesë për përjashtim. Për këtë u njoftua se pas aprovimit të kundërshtimit të tij se e paditura nuk është palë në procedurë dhe pas përfundimit të seancës të gjitha kërkesat ka të drejtë ti paraqes me parashtrësë... Pas çdo seance procesmbajtësja e bënë përmirësimin e gabimeve teknike dhe asgjë tjetër. Palët kanë pritur jashtë për procesverbal jo me shumë se 10 minuta. Të dy palëve ju është dorëzuar një kopje e procesverbalit dhe kanë pasur mundësi ta nënshkruajnë, po ashtu janë njoftuar se kanë të drejtë ti konstatojnë vërejtjet e tyre. Përfaqësuesi i paditësi e ka nënshkruar pa vërejtje. Përfaqësuesi i të paditurës nuk e ka nënshkruar dhe refuzimi është konstatuar në procesverbal”.*

Kryetari i Gjykatës Komerciale, si autoritet kompetent për pranimin e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe vendosjen e tyre, pasi shqyrtoi ankesën kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore me pretendimet si më lartë, shkresat e lëndës administrative përmes të cilave pretendohet se gjyqtarja ka bërë shkelje të ligjit dhe dispozitave ligjore, deklaratën e gjyqtares, si dhe shkresat e tjera, gjeti se kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore është e pabazuar.

*“Autoriteti Kompetent sipas nenit 9 paragrafi 1, shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12 paragrafi 2, përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore ose është parashkruar...”* – neni 9 paragrafi 6 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Bazuar në faktet e çështjes, rezulton se parashtruesi i kërkesës në po të njëjtën datë ka parashtruar kërkesën për përjashtim të gjyqtares. Po ashtu gjyqtarja me parashtrësën e datës 18.08.2023, ka kërkuar përjashtimin nga kjo lëndë me arsyetim se janë krijuar rrethana që do të mund të ndikonin

negativisht në perceptimin e pavarësisë nga njëra palë apo nga publiku. Kryetari i gjykatës pas analizimit të rastit dhe kërkesave të palëve ka konstatuar se nuk është gjetur ndonjë element thelbësor i përcaktuar me ligj si rrethanë për përjashtimin obligativ të gjyqtares, megjithatë për shkak të situatës së krijuar, për të eliminuar çdo dyshim lidhur me paanësinë e gjyqtares, me aktvendimin GjA.nr.5009/23 të datë 22.08.2023, ka vendosur që të aprovohen kërkesa për përjashtimin e gjyqtares për të gjykuar në këtë çështje.

Çështja e marrjes së vendimit në seancë nga gjyqtarja e rastit, me të cilën aprovohet kundërshtimi pas konstatimit që vendimi përfundimtar kundër të cilit hapet konflikti administrativ si organ i shkallës së dytë i nxjerrë nga MMPH dhe aktvendimi me të cilin lejohet ndryshimi i padisë në kuptimin subjektiv, si dhe veprimet e tjera të gjyqtares, janë aspekt i vlerësimit të juridiksionit të gjykatës së shkallës më të lartë, dhe kryetari i gjykatës nuk mund të vlerësoj profesionalizimin e gjyqtarëve nga ky këndvështrim, e as të vlerësoje vendimet e marra nga gjyqtarja.

Pretendimet se gjyqtarja ka bërë shkelje etike dhe profesionale, apo ka qenë e njëanshme me rastin e mos konstatimit të kërkesës për përjashtimin e saj nga kjo çështje administrative, rezultojnë si të pabazuara sepse nga materialet në dispozicion rezulton se kërkesa për përjashtim të gjyqtares është parashtruar pas përfundimit të seancës gjyqësore dhe gjyqtarja e ka udhëzuar palën për parashtrimin e kërkesës më shkrim. Ky konstatim rezulton edhe nga Raporti i monitorimit të “Betimi për Drejtësi” në të cilin jepen vërejtje lidhur me procedurën e zhvilluar, por nuk konstatohet kërkesa për përjashtimin e gjyqtares gjatës seancës gjyqësore.

Po ashtu pretendimi për ndryshimin e procesverbalit nga ana e gjyqtares pas përfundimit të seancës rezulton të jetë i pabazuar, sepse përveç deklaratës së ankuesit ky fakt nuk ka mundur të vërtetohet më asnjë prove tjetër, ndërsa nga deklarata e procesmbajtëses D.S. rezulton se në procesverbal janë përmirësuar vetëm gabimet teknike ndërsa parashtruesit të ankesës i është dhënë mundësia për shënimin e vërejtjeve, por i njëjti nuk ka pranuar as ta nënshkruaj procesverbalin.

Gjithashtu një pjesë e pretendimeve për mënyrën e marrjes së vendimeve gjatë kësaj seance të cilat vlerësohen me karakter udhëzues, bien jashtë juridiksionit të kompetencave të kryetarit të gjykatës, por mund të ngritën në pretendimet ankimore pranë Dhomave të Shkallës së Dytë, nëse kanë ndikuar në rregullsinë dhe ligjshmërinë e vendimit.

Rrjedhimisht, nuk mund të konstatohet se gjyqtarja ka trajtuar palën paditëse me subjektivizëm, apo të ketë qenë e njëanshme, dhe nuk mund të konkludohet se gjyqtarja ka bërë shkelje gjatë trajtimit të palëve gjatë seancës përgatitore. Nga faktet e konstatuara në shkresat e lëndës dhe rrethanave nuk mund të konstatohet një gjë e tillë, por mbetet në nivel të supozimeve, andaj si e tillë ankesa e paraqitur nuk përmban elementet e përcaktuara dhe informata bindëse se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore.

Po ashtu pretendimet e parashtruesit të kërkesës për inicim të procedurës disiplinore për përfshirjen e gjyqtares me qëllim për ta mbrojtur palën paditëse, janë të pabazuara dhe të njëjtat përbëjnë pretendime për shkelje procedurale të cilat mund të atakohen në procedura gjyqësore por nuk përbejnë shkelje disiplinore, të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore, nuk mbështetet në fakte dhe prova mbi të cilat do të ngritët eventualisht dyshimi mbi shkelje të supozuar disiplinore, andaj si e tillë refuzohet si e pa bazuar .

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

AD.GJKK.nr,3/23, më datë 04.09.2023

Mahir Tutuli

---

Kryetar i Gjykatës Komerciale